

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
TË  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"LA CLOCHE" SHPK**

Ky statut dhe akt i themelimit, Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Ligji nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "LA CLOCHE" SHPK.

**KREU I**

*Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimitarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e  
Përfaqësimit, Përgjegjësia e Asamblesë së Përgjithshme*

**NENI 1**

*Emri*

**1.1** Shoqëria mban emrin "**LA CLOCHE**" SHPK.

**1.2** Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

**NENI 2**

*Forma*

**2.1** Shoqëria "**LA CLOCHE**" SHPK ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

*Zyra Qëndrore*

**3.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**LA CLOCHE**" SH.P.K., e ka selinë në Shqipëri, Tiranë, Rruga e Bogdanëve 52, Pranë Ambasada e Polonisë. Numri i telefonit 0695735739 dhe adresa e emailit: [laclochevlore@gmail.com](mailto:laclochevlore@gmail.com)

**NENI 4**

*Objekti i veprimitarisë*

**4.1** Shoqëria ka për objekt veprimitarie:

- menaxhim bareve, restoranteve, tratorieve, tafinëve të nxheta dhe/ose ftohta, fast food, sandwichëve, barëve verërave, spageterëve, pestiçarëve, pjekësve, akulloreve, pubjeve, barëve të verës shoqërore, barkeve të verëve dhe mëngjesi, diskò, anzionet e larjeve dhe në përgjithsi menaxhimi i të gjitha aktivitetet lidhur me restorantet, përfshirë administrimin e pijeve alkoolike dhe super alkoholike;
- menaxhimi i laboratorive për prodhim dhe tregtimin e produkteve ushqimore dhe pijeve, ëmbëlsirave, përbajtjeve, gelato dhe creperia;
- menaxhimi i mensave në fabrike, në komunitetet private dhe publike, në universitet, shkolla dhe kompshte, në objektet shëndetësore publike dhe private, si dhe menaxhimin e shëndetësisë dhe të gjithë shëndetësore aktiviteti i restorantit, rekreacionit dhe argëtimit;
- catering me shërbim në shtëpi për organizimin e banketeve, dhe furnizim me shkakte të gatuara dhe të parapaketuara;



- tregti me pakicë dhe shumicë, gjithashtu me praktim të përfaqësuesve dhe / ose agjenciane përfaqësuese, me ose pa depozita, të gjitha produkteve të sektorit ushqimor, përfshirë produktet, produktet e peshkit, sh. shpirat, verëra, birra;
- kompania do të mund të trajnojë punonjës të çdo lloji dhe kategorie gjithmonë me referim në ushqimin dhe aktivitetet e ngjashme; organizoni kurset e gatimit dhe ofroni këshilla për kompanitë publike dhe private në fushën e ushqimit dhe pijeve shoqëria do të bëjë gjithashtu cdo transaksion tjeter, letra të vlerës apo pasuria e paluajtshme, të nevojshme dhe të dobishme për arrimin e qëllimit shoqëror, përfshirë kontraktimin e kredive me grantin e grantit;

**NENI 5**  
*Kohëzgjatja*

**5.1** Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "LA CLOCHE" SH.PK do të jetë për një periudhë të pacaktuar dhe mund të zgjatet.

**NENI 6**  
*Degët dhe zyrat e përfaqësimit*

**6.1** Shoqëria "LA CLOCHE" SHPK mund të hapë degët e saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**6.2** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. mund të vendosë, transferojë dhe/ose mbyllë, si brenda dhe jashtë shtetit shqiptar, zyra secondare, filiale, seli, agjenci, zyra përfaqësimi dhe bashkesi lokale të çdo natyre.

**KREU II**  
*Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit*

**NENI 7**  
*Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat*

**7.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "LA CLOCHE" SHPK. është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

**7.2** Ortakët e shoqërisë janë:

- 1. Z. MASSIMILIANO ADILARDI**, atësia GIAN CARLO lindur në ROMA (RM) Itali më 28.08.1969 me numër dokumenti passaport YB0731192, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5.000,00 (pes mijë) lekë e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 2. Z. NICOLA GENOVASI**, atësia ROBERTO, lindur në LECCE në Itali më 12.10.1982 me numër documenti karta identiteti AZ1536629, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 5.000,00 (pes mijë) lekë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë.

kapitali i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortakët e shoqërisë.

**NENI 8**

## ***Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar***

**8.1** Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

**8.2** Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kerkuar nga ligji.

### **NENI 9**

#### ***Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar***

**9.1** Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.

**9.2** Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

**9.3** Kuota mund të pjesëtohet për shkak të kalimit.

**9.4** Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### ***Organet e Shoqërisë, vendimmarrese dhe drejtuese***

### **NENI 10**

#### ***Organi Vendimmarres***

**10.1** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

**10.2** Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**10.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

**10.4** Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### **NENI 11** ***Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme***

**11.1** Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakët e Shoqërisë) do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë”.

**11.2** Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë. Vendimet e marra nga Ortakët, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë.

### **NENI 12** ***Kuorumi***

**12.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

**12.2** Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

**12.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **NENI 13** ***Marrja e vendimeve***

**13.1** Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**13.2** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve.
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **NENI 14** **Përjashtimi nga e drejta e votës**

**14.1** Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

**14.2** Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **NENI 15** **Administrimi**

**15.1** Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

**15.2** Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**15.3** Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai/Ajo ka të drejtë të:

- përfaqësojë shoqerinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët;
- të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe ti depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
- të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- të përgatisi dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhc, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;
- të krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- të kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
1. 15.4 Administratori i shoqërisë do të jetë Z. NICOLA GENOVASI, atesia ROBERTO, lindur në LECCE në Itali më 12.10.1982 me numër karta identiteti AZ1536629.

*Specimeni i nënshkrimit te administratorit:*

NICOLA GENOVASI

### NENI 16

#### *Kompetencat e Administratorit*

##### **16.1** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- 16.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### NENI 17

#### *Pergjegjesite e Administratorit*

- 17.1 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e

marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarise së shoqërisë në mjesid;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

#### **KREU IV**

#### *Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve*

#### **NENI 18**

#### *Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor*

**18.1** Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

**18.2** Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimitarise dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 19**

#### *Shpërndarja e Fitimeve*

**19.1** Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

**19.2** Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

#### **NENI 20**

#### *Ekspertët*

**20.1** Eksperti ka për detyrë qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e

rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

### **KREU V**

#### *Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë*

##### **NENI 21**

###### *Riorganizimi i Shoqërisë*

- 21.1** Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjeter, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.  
**21.2** Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

##### **NENI 22**

###### *Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë*

- 22.1** Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.  
**22.2** Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

##### **NENI 23**

- 23.1** Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

*Ky Statut hartohet dhe nënshkuhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinal qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"LA CLOCHE" SHPK**

**NICOLA GENOVASI**

*Nicola Genovasi*

**MASSIMILIANO ADILARDI**

*Massimiliano Adilardi*

Tiranë 06.06.2022